



Treni dhe autobusi

Komunikacioni publik në Zvicër është i ndërtuar shumë mirë. Praktikisht është pothuajse çdo vendbanim me trena apo autobusa i arritshëm. Mjetet e komunikacionit janë të përpikta dhe ngasin në kohë të rregullt.

Komunikacioni publik

Komunikacioni publik (ÖV) e ka në Zvicër një vend shumë të rëndësishëm. Pasi që pothuajse gati çdo vendbanim shumë herët është i arritshëm, e shfrytëzojnë shumë udhëtarë trenin apo autobusin. Ngasjet janë megjithë relativisht shtrenjët, mirëpo ka mundësi të ndryshme, të kursesh para. Kështu e vlen që të blehet, një abonament apo një kartë e lirë. Me një gjysëmtaksabonament(Halbtaxabo | abonnement demi-tarif) e paguan njeriu në tërë Zvicrën gjysmën e çmimit. Po ashtu ekziston mundësia, me blerë një biletë më të lirë për disa trena apo autobusë.

Biletat dhe abonamentet

Kush don ta shfrytëzoj trenin, duhet më parë ta blej një biletë (Billett). Nuk mund të blihen bileta në tren. Në autobusa është ndryshueshëm e rregulluar. Në çdo stacion të trenit dhe në shumicën e stacioneve për ndalje të autobusave gjenden automatat për bileta, në stacionet e mëdha të trenave ka sportele me shërbim. Biletat mundën online apo përmes handyt të blehen. Për personat që udhëtojnë shumë, ka abonamente të ndryshme. Këto janë për rrugë të veçanta, vende të veçanta apo në tërë Zvicrën rrjeti i komunikacionit abonamenti gjeneral (Generalabonnement | abonnement général) në shitje. Fëmijët deri në 6 vjeç me një person përcjellës ngasin falas. Deri në 16 vjeç udhëtoni s`bashku me prindërt apo gjyshërit gati falas, nëse ju e keni një kartë për junior-apo për nipërit (Juniorkarte, Kinder-Mitfahrkarte | Carte Junior, carte Enfant accompagné). Informacione për bileta dhe abonamente mund të merren në bashkësinë e trenave të Zvicrës (SBB | CFF) apo në ndërmarrjet e autobusave.

Kantoni Bern-LIBERO- shoqata e tarifave

Mbrenda kantonit të Bernit ofron shoqata për tarifa LIBERO tarifa speciale për bileta, abonamente dhe karta ditore. Rajoni është i ndarë në shumë zona. Biletat apo abonamentet janë në tren apo autobus të vlefshme vetëm në zonat e caktuara. Kush shkon përtej këtyre zonave i duhet një biletë tjetër shtesë.



Kanton Bern
Canton de Berne

hallo-bern.ch
salut-berne.ch

Kartat ditore të komunave

Kush e planifikon një udhëtim të gjatë mbrenda Zvicrës, mundet në shumë komuna ta nxjerr një kartë ditore me një çmim të ulët. Kjo ofertë është e kufizuar, njeriu duhet mjaftueshëm herët ta rezervoj. Informacione për këtë ofron administrata e komunës.

Lidhjet në natë

Në fundjavë ka në kantonin e Bernit edhe vonë në natë autobusa apo trena. Kujdes: në lidhjet e natës duhet njeriu një shtesë speciale për biletë ta paguaj.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/mobiliteti/treni-dhe-autobusi

hallo-bern.ch

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri
Mobiliteti / Treni dhe autobusi